REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:130849

Datë: 06.07.2020

Numri i dokumentit: 01009546

P.nr.366/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – **Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues **Drilon Haraçia**, me procesmbajtësen Valbone Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.A nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.646/19, të datës 17.04.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 29.06.2020, në prezencën e Prokurorit së shtetit Nazmi Krasniqi si dhe të akuzuarit dhe të dëmtuarit A.A. në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.06.07.2020**, këtë:

A K T GJ Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

I.A., nga i ati M., dhe e A.,, e gjinisë A., data e lindjes... në Komuna e Gjakovës, ku edhe banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar at i 4 fëmijëve, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, me numër personal...

Ë SH T Ë F A J T O R

Sepse me dt.24.04.2019, rreth orës 15,00 në Gjakovë, saktësisht në afërsi të shtëpisë së të dëmtuarit, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë të dëmtuarit A.A., në atë mënyrë që ditën kritike pas një mosmarrëveshje të atëçastshme që kishin pasur në mes vete lidhur me një tokë, fillojnë të fjalosen e më pas e kap me duar në fyt dhe e grushton në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të Dr. D.H. me numër të referencës Gj-236/19 dt. 31.05.2019.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 185 par. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N:

2019:130850

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500.00 (pesëqind) €uro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) ditëve, duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) €uro.

I dëmtuari A.A., nga Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari I.A., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej 20 (njëzetë) €uro, shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej nga 30 (tridhjetë) €uro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 30 (tridhjetë) €uro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.496/19, të datës 13.05.2019, kundër të akuzuarve A.A., dhe I.A. që të dy nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Armend Zenelej, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit. Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit të dytë I.A, nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti paraprakisht ka kuptuar natyrën dhe pasojën e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit I.A., ka mbështetjen edhe në provat dhe faktet të cilat janë pjesë të lëndës, andaj i propozoi Gjykatës që këtu i pandehuri I.A., të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit, po ashtu i njëjti të obligohet edhe në shpenzimet procedurale. Ndërsa shton se nëse Gjykata e sheh të arsyeshme ta veçoi procedurën ndaj të akuzuarit të parë A.A.

I akuzuari I.A., nga Komuna e Gjakovës, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikës së aktakuzës për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar dhe i kërkoi falje, shton se nuk do të kryej vepër penale në të ardhmen.

Gjykata sipas Aktvendimit P.nr.366/19 të dt.02.07.2020 e ka veçuar procedurën ndaj të akuzuarit A.A., nga Komuna e Gjakovës, meqë i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ku Gjykata në kuptim të nenit 36 t2ë KPP-së, e ka veçuar procedurën, e cila ka marr numër të ri të lendes P.nr.232/20.

Prokurori i Shtet Armend Zenelaj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit I.A. Pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë me vetëdije të plotë pa presion, i akuzuari paraprakisht e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ka mbështetjen dhe në provat dhe faktet që janë bashkangjitur aktakuzës. Andaj i propozoi Gjykatës që këtu të

2019:130850

akuzuarin ta shpall fajtor dhe ti dënoi sipas ligjit, po ashtu propozoi që gjatë vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit të Gjykata ti merr parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese të këtu të akuzuarit, njiherit propozojmë që të akuzuarin ta obligoj në pagesën e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari I.A., me dashje ka kryer veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi të lehtë trupor e kryen: *"Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor",* ndërsa nën paragrafi 1.4 ka përcaktuar se *"kur kemi dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit".*

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, e ka shpallur fajtor të akuzuarin I.A., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga 185 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohen, pendimin e tij duke i kërkuar falje palës së dëmtuar dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra

2019:130850

penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret ekzistojnë kushtet për të shqiptuar dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe ka ardhur në përfundim se edhe me dënimin me gjobë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së si dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëj rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko - civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. l të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.366/19, me datë 06.07.2020

Procesmbajtësja,
Valbone Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

2019:130850